



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1458/2 Prot.

Tirane, më 31.05 2024

VENDIM

Nr. 26 dt. 31.05 2024

“PËR

MIRATIMIN E PAGESËS SË ANËTARËVE TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR DHE KOMISIONEVE ZGJEDHORE TË FAKULTETEVE GJATË PERIUDHES ZGJEDHORE”.

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, të nenit 3; pika 3 dhe 4, të nenit 49, të Vendimit të Senatit Akademik nr.64 datë 23.04.2021 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin e Sporteve të Tiranës, neni 7 pika 12, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 35 datë 21.10.2019 “Mbi Miratimin e Rregullorës Financiare dhe e Shpërndarjes së të Ardhurave të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në shkresën e Komisionit Institucional Zgjedhor nr.1191 datë 25.04.2024 “Kërkesë për shpërblimin e anëtarëve të KIZ për veprimtarinë e kryer gjatë periudhës zgjedhore”, të Vendimit të Rektoratit me nr.36 datë 02.05.2024, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.38 datë 28.05.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 31.05.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e anëtarëve të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve gjatë periudhës zgjedhore duke filluar nga data konstituimit të tyre deri në certifikimin e rezultatit, si më poshtë vijon:

Komisioni Institucional Zgjedhor	25.000 lek/ muaj
Komisioni Zgjedhor i Fakultetit	15.000 lek/muaj

2. Pagesa e anëtarëve të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve mbulohet nga të ardhurat dytësore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Kjo Pagesë është vetëm për zgjedhjet e përgjithshme.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
5. Ngarkohet për publikim në faqen www.ust.edu.al dhe tek Transparenca Universitare, Drejtoria e Zhvillimit të Programve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BËRDIT TË ADMINISTRIMIT

